



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2022:037992

Datë: 17.07.2024

Numri i dokumentit: 05947857

PPP.nr.8/2022

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Avni Berisha, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit R me seli në Gjakovë, kundër debitori A (M) R nga fshati Radoste, Komuna e Rahovecit, duke vendosur lidhur me prapësimin debitorit të ushtruar kundër urdhërit përmbarimor të përmbaruesit privat Gj.R nga Gjakova, P.nr.846/2021 të datës 15.12.2021, jashtë seance, me datë 17.07.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. **APROVOHET PJESERISHT** prapësimi i debitori A (M) R nga fshati Radoste, Komuna e Rahovecit, dhe Urdhri për lejimin e përmbarimit P.nr.846/2021 të datës 15.12.2021, ne shume prej 1,052.57 euro, SHFUQIZOHET, i paraqitur kundër urdhrit të përmbaruesit privat Gj.R, me të cilin është caktuar përmbarimi sipas propozimit të kreditorit R me seli në Gjakovë, bazë të dokumentit te besueshëm faturës, lidhur me pagimin e borxhit ne shumën prej 1535.35 euro.
- II. **REFUZOHET** pjesërisht i pabazuar prapësimi i debitori A (M) R nga fshati Radoste, Komuna e Rahovecit, **MBETET NË FUQI** urdhri i përmbaruesit privat Gj.R, P.nr.846/2021 të datës 15.12.2021, për pjesën e borxhit ne shume prej 482.78 euro, me kamatë ligjore 8% nga dita e paraqitjes së propozimit (15.12.2021) e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.
- III. Ankesa kundër këtij aktvendimi, nuk e ndalon procedurën përmbarimore, përveç nëse janë dhënë garancitë për shumën e plotë të kredisë sipas nenit 78 të LPP-së.

A r s y e t i m

Sipas propozimit të kreditorit R me seli në Gjakovë, përmbaruesi privat Gj.R në Gjakovë, me urdhrin P.nr.846/2021 të datës 15.12.2021, ka parashtruar propozim për përmbarimi në bazë të dokumentit të besueshëm-faturës, kundër debitori A (M) R nga fshati Radoste, Komuna e Rahovecit, për pagesën e borxhit për furnizim me ujë për ujitje, në shumën e përgjithshme prej 1,535.35 €uro, me kamat vjetore, si dhe shpenzimet e procedurës të gjitha këto në afat 7 ditor në të kundërtën të bëhet bllokimi i llogarive bankare, sekuestrimi, regjistrimi dhe shitja e sendeve të luajtshme të paluajtshme e mbledhur në shumën e kërkuar të derdhen në llogari të kreditorit të gjitha këto të specifikuar në propozimin për përmbarim të datës 15.12.2021.

Organi përmbarues me urdhrin P.nr.846/2021 të datës 15.12.2021, ka lejuar përmbarimin sipas propozimit të kreditorit.

Kundër urdhrin me të cilin është caktuar përmbarim, debitori brenda afatit ligjor ka paraqitur prapsim me shkrim me të cilin e ka kontestuar urdhrin, ka theksuar se se borxhi i është parashkruar duke u bazuar në nenin 360 par. 1 nënpar 1.1 të LMD, andaj i kanë propozuar gjykatës që të aprovet prapësimi i tyre, dhe të hedhet propozimi për përmbarim i kreditorit si i pabazuar.

Kreditori ndaj prapësimit të debitorit ka dhënë përgjigje me shkrim, me të cilin e ka kundërshtuar tërësisht pretendimet e debitorit si të pabazuara duke theksuar se në këtë rast nuk kemi të bëjmë me parashkrimin në afatin një (1) vjeçar që është afat i parashkrimit për shërbime komunale dhe për nevoja të domosdoshme shtëpiake (amvisërisë), ndërsa uji për ujitjen e tokave bujqësore nuk hynë në shërbime të amvisërisë, andaj duke u bazuar në nenin 353 të LMD-se nuk kemi të bëjmë me afati një vjeçar të parashkrimit por afatin tre (3) vjeçar, si dhe ka theksuar që debitori e ka pranuar borxhin duke paguar kohe pas kohe shumën të ndryshme, andaj në bazë të nenit 368 par 1 dhe 2 të LMD-së, pretendon edhe nëse do të ekzistonte parashkrim është ndërprerë me pagesat periodike të cilat i ka paguar debitori kohe pas kohe.

Gjykata pas shqyrtimit të propozimit të kreditorit, urdhrin për caktimin e përmbarimit, prapësimit të debitorit, përgjigjes në prapsim të kreditorit, ka ardhur në përfundim se prapësimi i debitorëve është i pjesërisht i bazuar. Gjykata ka ardhur në përfundim se në këtë çështje kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës së kreditorit në kuptim të nenit 71 par.1 nën par 1.4 të LPP-së, sipas të cilit parashihet se *“ka skaduar afati kohor brenda të cilit, sipas ligjit, mund të kërkoet përmbarimi”*.

Gjykata vërtetoi faktin se në bazë të dokumentit të besueshëm faturës nr.0016812, të datës 12.12.2021, si dhe kartelës së konsumatorit, debitori ka krijuar borxh ndaj kreditorit në shumën prej 1,535.35 euro, për furnizim me ujë për ujitje për periudhën kohore nga 20.09.2010 deri me 15.12.2021. Pretendimet e debitorit në prapësim se rastin konkret është arritur parashkrimi i borxhit, gjykata i merr si pjesërisht të bazuar, për shkak se kërkesat që parashkruhen në afta një (1) vjeçar sipas nenit 360 të LMD-së, janë për shërbime që përdoren për nevojat shtëpiake, ndërsa në rastin konkret debitori ka shfrytëzuar ujin për ujitje. Mirëpo kërkesat e realizimit të borxhit të konsumatorve siç është debitori parashkruhen pas kalimit të afatit prej tre (3) viteve nga momenti kur arrin kërkesa për pagesë. Parashkrimi rrjedhe për secilin muaj veç e veç. Në

këtë rast shuma e borxhit në vlerën prej 1,052.57 euro e krijuar për periudhën kohore nga 20.09.2010 deri më 14.12.2018, është parashkruar konform nenit 355 par.1 të LMD-së, për faktin se edhe pse debitori nga kartela e konsumatorit shihet se gjatë kësaj periudhe ka bërë disa pagesa paushallë, mirëpo nuk ka dëshmi se këto pagesa janë bërë në emër të borxhit paraprak apo në emër të faturave për muajt vijues dhe me vete faktin se ndërmjet kreditorit dhe debitorit nuk ka ekzistuar një marrëveshje për ri programin eventual të borxhit këto pagesa nuk e kanë bërë ndërprerjen e rrjedhjes të afatit të parashkrimit konform nenit 368 të LMD-së.

Pagesat e kohëpaskohshme në lartësi dhe shume të ndryshme të bëra nga debitori nuk mund të llogarit siç pretendon kreditori. Në nenin 368 par.2 të LMD-se përcaktohet “*Pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veçse edhe në mënyrë të tërthortë, sikurse janë pagesa e këstit, pagesa e kamatës, dhënia e sigurimit*”. Në rastin konkret referimi i pagesave të kësteve nuk mund të përfshijë pagesat paushallë në emër të borxhit të përgjithshëm, pasi që termi “këst” iu referohet pagesave të paracaktuara me marrëveshje në mes të kreditorit dhe debitorit, e që në këtë rast gjykata nuk u bind vetëm me pretendime deklarative (të pambështetura me prova konkrete). Andaj, në këtë rast gjykata vlerëson se nuk kemi të bëjmë me ndërprerje të parashkrimit, i paraparë me nenin 368 paragrafi 1 të LMD-së, pasi që ndërprerja e parashkrimit në këto raste bëhet për secilën kërkesë veç e veç, ndërsa pagesat e realizuara sikurse në rastin e debitorit, të njëjtat nuk iu kanë referuar pagesës së ndonjë fature konkrete, veçse nga ana e tij janë bërë pagesa paushalle, andaj në raste të tilla, këto pagesa bëjnë shlyerjen e borxhit të parë të krijuar të debitorit në drejtim të kreditorit, e assesi ndërprerje të parashkrimit, siç edhe është pretenduar nga kreditori.

Dispozita ligjore qarte e përcakton dhe nuk e cek faturën dhe shumën më të madhe sesa fatura sepse pala gjate pagesës ka mundësi të paguaj më tepër sesa borxhi dhe ajo i llogaritet si avans për muajin tjetër, por assesi nuk llogaritet këst.

Meqenëse kreditorja ka ushtruar propozim për përmbarim me datën 15.12.2021, e ka ndalur parashkrimin e borxhit për tri (3) vite në mënyrë retroaktive. Gjykate gjeti se nga kartela e konsumatorit se debitori për periudhën nga 15.12.2018 deri me 15.12.2021 ka krijuar borxh në vlerën prej 482.78 euro, për të cilin gjykata vendosi ta lërë në fuqi urdhërin e përmbaruesit privat sepse nuk ka kaluar afati caktuar me ligj në kohëzgjatje prej tre (3) viteve, ashtu që nuk ka parashkrim komform nenit 369 të LMD-se, i cili përcakton se: “*Parashkrimi ndërprehet me paraqitjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarr kundër debitorit para gjykatës ose autoriteti tjetër kompetent me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës*”.

Gjykata vendosi që ta aprovoj pjesërisht prapsimin e debitorit dhe pjesërisht ta lere në fuqi urdhërin e përmbaruesit privat, e duke u bazuar në nenin 29 par.1 nën par.3 të LPP-së, ku ndër të tjera është cekur: *Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji*, ndër të tjera, është edhe fatura, e po ashtu në paragrafin 3 të këtij neni është cekur: *Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe së në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*.

Andaj gjykata, ka ardhur në përfundim se pretendimet e debitorit të cekura në prapsim, nuk janë bazë e mjaftueshme, e as pengesë për lejimin e përmbarimit në rastin konkret, lidhur me propozimin e kreditorit për borxhin si në pikën II të dispozitivit, në bazë të dokumentit të besueshëm – faturës.

Andaj nga të cekurat më lartë, e në kuptim të nenit 73 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil
PPP.nr.8/2022, më 17.07.2024

Gj y q t a r i
Avni Berisha

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditëve, nga dita e pranimit. Ankesa ushtrohet përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.